



VENDIM

Nr.22 Datë 18.03.2009

PËR

**FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR MIRATIMIN E “KONTRATËS
PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE NDËRMJET
SHOQËRISË KESH SH.A (FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË)
DHE SHOQËRISË OSSH SH.A (FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICË)
PËR PERIUDHËN 01.01.2009 DERI MË 31.12.2009**

Në mbështetje të neneve 9, dhe 26, të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“ i ndryshuar; pikës 4.13 gërma a, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me VKM nr.338, datë 19.03.2008, pikës V.1, të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.68 dt. 23.06.2008, nenit 18, pika 1, gërma c, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s“ të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr.44, datë 24.07.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.03.2009, pasi diskutoi mbi draftin e kontratës “Për furnizimin me energji elektrike ndermjet shoqerise KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumice) dhe shoqerise OSSH sh.a (Furnizuesit Publik me Pakice) per periudhen 01.01.2009 deri me 31.12.2009“ ,

Konstatoi se :

- Kontrata është lidhur nga KESH sh.a dhe OSSH sh.a, subjekte të licensuara nga ERE, përkatësisht me vendimet Nr. 9 datë 25.01.2008 dhe Nr. 11 datë 23.06.2006, të ndryshuar,
- Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike dhe Rregullat e tregut të energjisë elektrike përcaktojnë se kjo kontratë i nënshtrohet tregut të rregulluar



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



- Në referencë të akteve të sipërcituara, ERE është autoriteti i përcaktuar për miratimin e kësaj kontratate,

Për sa më sipër evidentuar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e kontratës „Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumicë) dhe shoqërisë OSSH sh.a (Furnizuesit Publik me Pakicë) për periudhën 01.01.2009 deri më 31.12.2009.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesit për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe ndjekjen e mëtejshme të procedurave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr.22 Datë 18.03.2009

PËR

**FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR MIRATIMIN E “KONTRATËS
PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE NDËRMJET
SHOQËRISË KESH SH.A (FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË)
DHE SHOQËRISË OSSH SH.A (FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICË)
PËR PERIUDHËN 01.01.2009 DERI MË 31.12.2009**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkeqim Bozgo	_____	_____